

SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
RETAIL PARK SH.P.K.
ME SELI NË : "RRUGA LUIGJ GURAKUQI, PALLATI 89, SHK.1, AP.33, TIRANË, SHQIPËRI
REGJISTRUAR PRANË REGJISTRIT TREGTAR ME NUMËR IDENTIFIKIMI
L71515042Q

VENDIM

I

ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË

Sot, më 16.12.2021, në orën 12.00, në selinë e Shoqërisë "**Retail Park**" Sh.p.k., regjistruar në regjistrin tregtar me numër identifikimi L71515042Q, me adresë në "Rruga Luigj Gurakuqi, pallati 89, shk.1, ap.33, Njësia Bashkiake nr. 2, Tiranë, Shqipëri (më tej referuar si "**Shoqëria**"), mbahet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë, me të pranishëm:

1. "**Balfin-Balkan Finance Investment Group**" Sh.p.k., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar në përputhje me legjislacionin shqiptar, me NUIS K72223031K dhe seli të regjistruar në adresën Rruga Papa Gjon Pali II, Kati 11, ABA Business Center, Tiranë, Shqipëri, me ortak të vetëm, Z. Samir MANE, e cila zotëron 100% të kapitalit të Shoqërisë, e përfaqësuar ligjërisht nga znj. Edlira Muka në cilësinë e administratores së shoqërisë Balfin sh.p.k. ("**Ortaku i Vetëm**").

Znj. Edlira Muka e cila merr përsipër të kryesojë mbledhjen, fton znj. Ada Gramatiku, e cila pranon, të kryejë funksionin e sekretarit. Kryetari i Asamblesë pasi deklaron vullnetin e Ortakëve për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, e deklaron Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dytë të nenit 83 të Ligjit nr. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim:

RENDI I DITËS

I. ZMADHIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË RETAIL PARK SH.P.K.

Duke kaluar në diskutimin e çështjes së parë të Rendit të Ditës, Kryetari parashtron se për nevoja të Shoqërisë për investime që do të kryejë, kërkohet financimi i saj me një shumë prej 12,000,000 LEK (dymbëdhjetë milion lekë). Financimi do të jepet në formën e kontributit në kapitalin e Shoqërisë, i cili nga 32,500,100 LEK (tridhjetë e dy milion e pesëqind mijë e njëqind lekë) do të zmadhohet në 44,500,100 LEK (dyzet e katër milion e pesëqind mijë e njëqind lekë).

Pas një shqyrtimi të kujdesshëm të çështjes së dytë në Rend të Ditës, Ortaku i Vetëm:

VENDOSI

- A. Të miratojë zmadhimin e kapitalit të shoqërisë Retail Park sh.p.k. (NUIS: L71515042Q) me 12,000,000 LEK (dymbëdhjetë milion lekë). ("**Zmadhimi i Kapitalit**");
- B. Zmadhimi i Kapitalit do të nënshkruhet dhe është shlyer tërësisht nga Ortaku i Vetëm në para, në datë 04.11.2021.

- C. Kapitali i Shoqërisë pas zmadhimit nga 32,500,100 LEK (tridhjetë e dy milion e pesëqind mijë e njëqind lekë) do të bëhet **44,500,100 LEK (dyzet e katër milion e pesëqind mijë e njëqind lekë)**.
- D. Të autorizojë përdorimin e kapitalit të injektuar për investime të parashikuara nga Shoqëria.
- E. Të autorizojë Administratorin në detyrë të Shoqërisë, për të kryer të gjitha aplikimet e nevojshme me qëllim regjistrimin e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, personalisht ose nëpërmjet autorizimit të personave të tjerë për këtë qëllim.

Meqenëse nuk pati asnjë çështje tjetër për të diskutuar, Kryetari e deklaron mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë të mbyllur në orën 13.00.

**ASAMBLE E PËRGJITHSME E SHOQËRISË
RETAIL PARK SH.P.K.**

KRYETAR


ZNJ. EDLIRA MUKA



SEKRETAR


ZNJ. ADA GRAMATIKU

